



Kontrata për Ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”

Tetë marrëveshje, tre impakte të mëdha!



Prill, 2018

Përmbajtja

Hyrje	2
Fiasko financiare	3
Financimi përmes kredisë	6
Një marrëveshje anti-evropiane	11
Dhunë për mjedisin dhe shëndetin	15
Përfundime	16

Hyrje

Më 19 janar 2018, Ministria e Zhvillimit Ekonomik publikoi kontratën tashmë të nënshkruar për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” me operatorin Contour Global. Publikimi i dokumenteve u bë një muaj pasi u nënshkrua në një ngjarje mjaftë të promovuar nga krerët e shtetit. Tetë kontratat që rumbullakësonin një projekt gjigant u publikuan tek pasi Kosova kishte nënshkruar të gjitha obligimet që vinin nga to. Pra, kishim të bënim me transparencë jo si mjet për të përmirësuar vendimmarrjen, por si mjet për të arsyetuar atë përmes një veprimi *ex post*.

Konsorciumi Kosovar i Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) kanë analizuar këto kontrata dhe jemi të bindur që kemi të bëjmë me kontratën më të dëmshme për Kosovën në gjithë historinë e saj moderne. Kontrata krijon një humnerë financiare njëzet vjeçare për vendin, e izolon atë nga integrimi dhe liberalizimi i tregut të energjisë elektrike dhe shuan shpresat për një sistem energjetik të bazuar në burime të pastra e miqësore me mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

Nëse kjo kontratë vihet në jetë, Kosova do të marrë përsipër kosto të papërballueshme dhe të pa merituar. Buxheti i shtetit do të rëndohet dhe shumë projekte jetike për Kosovën nuk do të mund të realizohen për shkak të fokusit në mbulimin e kostove të investimit miliardësh. Contour Global me asnjë logjikë ekonomike nuk mund të quhet investitorë. Përkundrazi, ai është një kontraktorë që do të realizoj një kontratë me as edhe një rrezik të vetëm për kapitalin e tij. Një kompani që as vet nuk do ta realizoj ndërtimin e as menaxhimin e projektit pasi të njëjtën mund ta nënkontraktojë! Një kompani që ka negociuar secilin qosh të kontratës në dëm të Kosovës dhe që do ta ketë të sigurt profitin njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë, njëzet vjet!

Kjo kontratë dëmton të ardhmen evropiane të Kosovës. Duke qenë palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova duke e vënë shtetin në shërbim të një operatori privat ka shkelur me dy këmbë parimet e liberalizimit të tregut, politikën evropiane për integrim të tregjeve, rregullat vendore dhe evropiane për konkurrencë të lirë të tregut dhe legjislacionin evropian për ndihmën shtetërore. Kontrata për ndërtimin e termocentralit të ri sublimon një politikë të vjetër të subvencionimit shtetëror për një kompani të caktuar, vë një operator në pozitë ekskluzive në treg vret interesin e konsumatorëve për energji të përballueshme.

Ndërtimi i termocentralit të ri nga qymyri po bëhet pa një vlerësim të ndikimit në mjedis dhe pa një analizë të impaktit social. Kushtetuta e Republikës së Kosovës kërkon qartazi që për ëdo projekt që ka implikime në mjedis, të ketë garanci që ëdo qytetarë të ndikoj në vendime dhe që ndikimi në mjedisin jetësor të merret parasysh gjatë marrjes së vendimeve.

Neni 52 ëPërgjegjësia për Mjedisin Jetësorç

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

2. *Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.*

3. *Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.¹*

Qeveria e Kosovës ka negociuar një kontratë miliardëshe pa parrë parasysh ndikimin në mjedis dhe në shëndetin e popullatës dhe pa zhvilluar procese të mirëfillta të konsultimit me publikun. Përfundimisht, ndërtimi i termocentralit të ri nga qymyri nuk ka marrë parasysh nevojat e Kosovës për integrim të tregut me tregjet rajonale dhe evropiane. I gjithë planifikimi, negociimi dhe finalizimi i kontratës është bërë në kushtet e një tregu të izoluar ku qymyri “është zgjidhja e vetme” ose zgjidhja ideale për ta ushqyer sistemin.

Kontrata për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” është e dëmshme për arsye se në aspektin financiar është dërrmuese, në aspektin mjedisor dhe social e paparashikueshme dhe në aspektin e integritit evropian është izoluese dhe shkurtpamëse. Nga ideja e keqe për ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr, deri tek kontrata e tmerrshme për realizimin e saj! Në vijim do të paraqesim aspektet financiare, mjedisore dhe të integritit përse kjo kontratë dhe ky projekt duhet refuzuar dhe ndaluar!

Fiasko financiare

Përkundër që mund të argumentojmë se Kosova nuk ka nevojë për një termocentral të ri nga qymyri, në kushtet e tanishme të nënshkrimit të kontratës, na duhet të analizojmë aspektet financiare të saj. Me këtë marrëveshje Kosova do të ngujohet për të blerë energji të prodhuar nga qymyri nga një operatorë privat për njëzet vitet e ardhshme. Për më tepër, një pjesë tejet e madhe e investimeve paraprake do të kryhen nga Qeveria e Kosovës për të shtruar rrugën që operatori privat të realizoj investimin dhe fitimin e tij.

Seksioni 3.6 pika a)² e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike e obligon Kosovën që të ofrojë ujë me nje kualitet te caktuar per Termocentralin. Specifikat e kerkesave të kualitetit të ujit duhet të jenë në pajtim me GenCo (Contour Global). Me këtë nen, Kosova është teknikisht e obliguar për të krijuar tender për furnizim me ujë sipas kualitetit të cilin e kërkon GenCo. Furnizimi sipas të gjitha gjasave do të kërkojë vendosjen e një fabrike të ujit për kërkesa të veëanta të GenCo, dhe do të jetë një investim shumë i shtrenjtë. Kjo gjithashtu nuk përkon me futjen e një operatori plotesisht komercial në treg, meqenëse ky operator po kerkon krijim të kushteve nga shteti, dhe nuk gjenë zgjidhje ne ekonomi te hapur për kërkesat e veta.

Gjithashtu, ky nen në kontratë e obligon Qeverinë e Kosovës të kërkojë aprovimin e specifikave të dosjes së tenderit para publikimit nga Genco.

¹ Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 52, Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor, Prishtinë: GZRKS.

² Power Purchase Agreement, 3.6 a).

Seksoni 3.7³ i Kontratës së Blerjes së Energjisë Elektrike e obligon Qeverinë e Kosovës të bëjë një Analizë të Impaktit Mjedisor dhe Social. Në shembujt e shteteve perendimore, një plan i tillë duhet të përgatitet nga operatori ekonomik dhe të pranohet apo të refuzohet nga qeveria, si pjesë e marrjes së licencës. Ky studim kërkon specifika teknike të analizës së erës, lartesisë së oxhakut, emisionëve etj. Tek pastaj, GenCo do të bëjë një Analizë të veten dhe kjo kontratë nuk e detyron GenCo t'i përmbahet gjetjeve dhe përfundimeve të analizës së Kosovës.

Përveç investimeve masive në flotacion të qymyrit (mbi 300 milion) dhe infrastrukturës përcjellëse, Studimet që kërkohen sipas seksionit 3.8 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë dhe për të cilat Kosova do të paguaj:

- a) Të kryej Studimin Seizmik
- b) Të kryej Anketën Meteorologjike
- c) Të kryej Anketën Topogjeografike
- d) Të kryej Vlerësimin e Rrezikut të Përmbytjeve
- e) Të kryej Studimin Gjeologjik dhe Gjeoteknik
- f) Të kryej Anketën e Vlerësimit të Bombardimit
- g) Të kryej Anketën e Vështirësive Nëntokësore
- h) Të kryej Analizën e Ujit të Papërpunuar
- i) Të kryej çdo studim ose anketë që i shërben EPC kontraktorëve të pranojnë rreziqet e kushteve të ndryshme të tokës.

Në seksionin 3.9 të Kontratës së Blerjes thuhet që Contour Global do të bëjë tender ndërkombëtar për EPC (Engineering, Procurement and Construction) dhe LTM (Life Time Management). Ose do të ketë dy nënkontraktorë ose një kombinim të të dyve nëpërmjet konsorciumeve. Kjo do të thotë që GenCo nuk do të ketë rol ekzekutues operacional, por vetëm planifikues dhe mbikeqyrës.⁴ Kombinime të tilla zakonisht shpiejnë qoftë në keqmenaxhim të ndërtimit dhe menaxhimit për shkak se nën-kontraktorët kanë incentive për zvogëlimin jo-legal të shpenzimeve apo në rastin të cilin në besojmë që po ndodhë në Kosovë, në rritje të ëmimit.

Kontrata madje nuk obligon Contour Global që të kryej menaxhoj planifikimin, ndërtimin dhe menaxhimin e projektit por që të lidhë marrëveshje me

Kushtet e tenderit i vendosë GenCo me aprovim të Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, Kosova duhet të përgjigjet brenda 20 ditëve pasi që i janë dorëzuar specifikat e tenderit për EPC/LTM në të kundërtën GenCo do të procedoj pa aprovim të Qeverisë. Kjo mundësi që Contour Global e ka lënë në kontratë në mënyrë që të procedoj më

GenCo do ta zhvilloj tenderin për Owner's Engineer (Inxhinjerin e Pronarit) i cili është një procedurë standarde financiare e kontratave të tilla. Megjithatë, është dashur që teknikisht të ketë dy inxhinjer të pronarit meqë janë dy pronarë (Kosova dhe Contour Global). GenCo do ta

³ Power Purchase Agreement, 3.7.

⁴ Ibid, seksioni 3.9.

bëjë tenderin dhe nuk dihet interesat e kujt do t'i mbrojë GenCo. Gjithashtu, nëse GenCo nuk e luan rolin e Inxhinjerit të Pronarit përse na duhet GenCo në fund të fundit?

Kontrata parasheh së paku pesë kontraktorë:

- EPC – Engineering, Procurement and Construction (Inxhinjering, Prokurim dhe Konstruktim)
- LTM – Life Time Management (Menaxhim i përhershëm)
- O&M – Operations and Maintenance Contractor (Kontraktori i Operacioneve dhe Mirëmbajtjes)
- GenCo Connection Assets – për kontraten për interkoneksion nga dalja e rrymës edhe lidhja me rrjet të KOSTT,
- Environmental Protection Contractor - Kontraktori për Mbrojtje Mjedisore (Opsional)

Sipas Nenit 10.1.2 NKEC (Apo MZHE, e cila përfaqëson Qeverinë, sipas faqës së parë të kontratës), është e obliguar të paguaj të gjithë neto rrymën e dalë nga Kosova e Re.

Gjithashtu, në pikën c të këtij neni

- (c) reimburse GenCo for the take or pay payments to KEK Mining in relation to the quantity of Lignite contracted under the Lignite Supply Agreement in accordance with Section 16.2; and
- (d) prior to the Commercial Operations Date, take delivery of and pay for NKEC Acceptance Test Energy in accordance with Article 16 and Schedule 1.

Sipas nenit 16.2⁵ Qeveria e ka për detyrë me e rimbursu GenCo për të gjitha sasi të linjtit që rrjedhin si pasojë e “Take or pay” agreement me KEK Mining, përveç në rastin kur Genco nuk ka arritur të përmbushë take-or-pay agreement për shkak të paaftësisë së GenCo për të gjeneruar rrymë. Nën një treg të lirë të energjisë, Qeveria e Kosovës nuk duhet të paguaj kosto të linjtit në rast se bie fjala ka rënje të kërkesës për energji në treg.

Sipas nenit 27.12 Marrëveshja interpretohet sipas ligjeve të New York-ut.

Përveç kostove të jashtëzakonshme përgatitore deri në realizimin e projektit, një projekt i tillë do të shkaktoj rritje të emimeve të energjisë elektrike. Kjo për arsye se kostot përfundimtare të ndërtimit të tij nuk dihen ende. Nënkontraktorët do të kenë interes rritjen e kostove në mënyrë që fitimi i tyre të jetë më i madh. Përfundimisht, me faktin që ne obligohemi të blejmë tërë energjinë e prodhuar për tërë periudhën njëzet vjeçare do të thotë se për afërsisht treqind milion euro në vit do të hargjojmë për blerje të energjisë nga operatori privat.

Përderisa për njërin nga operatorët në treg do të paguhet aq sa do të prodhojë, me emim të garantuar dhe me dispeçim preferencial⁶. Vendosija në treg me përparësi e vë këtë operator

⁵ Power Purchase Agreement, 16.2.

⁶ Vendosije në rrjetë me përparësi. Para kësaj kontrate, përparësi në dispelëim kishte vetëm energjia e prodhuar nga burime të ripërtrishme.

privat në pozitë të favorizuar ndaj operatorët e tjerë. Kjo na shpie menjëherë tek standardet evropiane të tregut të lirë, të konkurrencës dhe të ndalimit të ndihmës shtetërore.

Financimi i ndërtimit të termocentralit u parapa të bëhet me një strukturë financiare ku 70 përqind e koston pritet të mbulohet nga financimi përmes kredisë dhe 30 përqind nga investimi përmes kompanisë private Contour Global, si investitor i përcaktuar për përmbushje të këtij obligimi. Me një strukturë të tillë të financimit, 910 milion euro do të financohen përmes kredisë si dhe 390 milion do të financohen përmes investimit privat. Kostoja e ndërtimit prej 1.3 miliardë euro apo edhe nesë do të ishte vetëm 1 miliardë euro me një shumë kaq të madhe të kredisë paraqet një morri brengash she risqesh të aspektit politik dhe rregullator të cilat duhen të mirren parasysh.

Financimi përmes kredisë

Kredia përmes së cilës është parapa përmbushja e 70 përqind e koston, pritet të arrihet me një normë të kthimit prej 7.5 përqind. Kjo normë e kthimit merret si e tillë duke konsideruar që pjesa tjetër nga vlera e vërtetë e normës (e cila mund të mbërrijë deri në 18 përqind dhe për të cilën do të bisedohet më specifikisht në analizat e sensitivitetit mëposhtë) mund të subvencionohet. Për këtë arsyeje vlera aktuale e normës së kthimit pa përfshirë subvencionimin në normën e kthimit për qëllim të kësaj analize merret të jetë 18 përqind. Kthimit i kredisë pritet të bëhet për një periudhë prej 20 viteve. Duke marrë parasysh këto të dhëna, kostoja e interesit në kredi për gjatë gjithë kësaj periudhe të specifikuar do të arrijë vlerën deri në 1.36 miliardë euro. Në realitet, është e mundshme që Qeveria e Kosovës të arrin marrëveshje për kredi më normë të interesit 7.5 përqind apo edhe më të ulët dhe nuk ka nevojë për subvencionim, por duke konsideruar rrethanat ekonomike në vend, është e vështirë të mendohet se një normë kaq e favorshme është e mundshme të arrihet në këtë periudhë. Për këtë arsyeje në koston totale të ndërtimit të TC “Kosova e Re”, përfshihet edhe subvencionimi i koston së interesit (shih Tabela 2).

Se sa e suksesshme do të jetë Qeveria e Kosovës të sigurojë këtë shumë të kredisë mbetet të shihet. Mirëpo, duke marrë parasysh natyrën e këtij investimi të ndërtimit të termocentralit me lëndë djegëse sië është qymyri, i njohur të mos jetë ekologjik dhe ndikon dëmshëm në ambient, në parim nuk duket aspak tërheqëse për marrje të kredisë nga bankat zhvillimore ose institucionet e tjera financiare e aq më pak me normën mjaft të ulët të kthimit prej 7.5 përqind. Për më tepër, faktorët të cilët masin kualitetin e marketeve financiare në vend si dhe norma e interesit të kredive në bankat komerciale e cila po ashtu pasqyron riskun në mundësinë e dështimit të kthimit të kredisë, parashohin normë shumë më të lartë të interesit sesa 7.5 përqind. Një situatë e tillë mund të kuptohet edhe nga kërkesa paraprake për normë të kthimit prej 21.5 përqind nga investitori privat, qe po ashtu pasqyron shkallën e lartë të riskut në këtë investim.

Në marrvëshjen e fundit kjo normë është ulur si rezultat i marrëveshjeve mes palëve të involvuar, por do të ishte akt i përshpejtuar nëse mendohet se norma e interesit është ulur për shkak se risku është ulur për një kohë kaq të shkurtër.

Një analizë e sensitivitetit të normës së kthimit në kredi paraqet edhe skenarët e ndryshëm të rritjes apo zvogëlimit të financimit përmes kredisë varësisht nga ndryshimi në normën e interesit e cila ende pritet të përcaktohet. Tabela më poshtë shfaq këtë analizë.

Shuma e kredisë	Norma e interesit	Shuma e kthyer për 20 vite	Shuma e paguar në interes
910,000,000	2%	1,274,000,000	364,000,000
	7.5%	2,275,000,000	1,365,000,000
	9%	2,548,000,000	1,638,000,000
	18%	4,186,000,000	3,276,000,000

Tabela 1. Analiza e sensitivitetit të kredisë ndaj ndryshimit të normës së kthimit (vlerat në euro)

Nga këto parashikime shihet se në rastin më të mirë të mundshëm nëse Qeveria e Kosovës arrinë të sigurojë kredinë me 2 përqind të normës së kthimit, vlera totale e cila duhet të paguhet nga Qeveria e Kosovës mund të mbërrijë vlerën e 1.2 miliardë euro. Në rast se arrihet të sigurohet kredia me normën e kthimit prej 7.5 përqind, ashtu sië është paralajmëruar së fundmi, vlera totale e cila duhet të mbulohe nga buxheti i Kosovës mbërrin vlerën e 2.2 miliardë euro.⁷ Dy skenarët shtesë të normës së kthimit, 9 përqind dhe 18 përqind poashtu janë inkorporuar në analiza për arsyeje të ndryshme. Norma 9 përqind është menduar të arrihet pasi që në marrëveshjen e publikuar për termocentralin e ri norma e kthimit të investimit privat është ulur nga 21.5 përqind në 18.5 përqind, kjo ulje është e mundur të pasqyrohet pjesërisht në rritje të interesit për pjesën e financuar nga kredia (rritja nga 7.5 përqind në 9 përqind). Në një rast të tillë, vlera totale e cila duhet të mbulohe nga Qeveria e Kosovës mbërrinë vlerën e 2.5 miliardë euro. Në analizat e fundit të publikuara nga IEEFA është sqaruar qartë se norma reale e interesit për këtë projekt mund të jetë 18 përqind apo edhe më lartë, kjo duke konsideruar normën aktuale të kredive komerciale në bankat e Kosovës (në një interval prej 14 përqind e deri në 16.6 përqind), si dhe faktorët e tjerë të cilët përcaktojnë nivelin e riskut në markete financiare në vend.⁸ Në një rast të tillë, vlera totale e cila pritet të mbulohe mbërrinë vlerën prej 4.1 miliardë euro, kosto e cila mund të jetë vështirë e përballeshme për vendin tonë.

Financimi përmes investitorit privat

⁷ Institute for Energy Economics and Financial Analysis, The proposed New Kosovo Power plant: An unnecessary burden at an unreasonable Price, Janar 2016, faqe 26, http://ieefa.org/wp-content/uploads/2016/01/The-Proposed-New-Kosovo-Power-Plant_-Jan-2016.pdf

⁸ Institute for Energy Economics and Financial Analysis, The proposed New Kosovo Power plant: An unnecessary burden at an unreasonable Price, Janar 2016, faqe 15, http://ieefa.org/wp-content/uploads/2016/01/The-Proposed-New-Kosovo-Power-Plant_-Jan-2016.pdf

Nga kostoja totale e ndërtimit të termocentralit, 30 përqind parashihet të përmbushet nga investimet e investitorit privat, Contour Global. Norma e kthimit të investimit prej 390 milion euro është dakorduar me marrëveshje të jetë 18.5 përqind si dhe me aplikim të interesit dy herë në vit. Analizat e mëposhtme (Tabela 2) marrin parasysh periudhën kohore të amortizimit total të kredisë për 3 dhe 5 vite si dy skenarë të mundshëm pasi që kjo nuk është e specifikuar në marrëveshjen e fundit të publikuar. Me specifika të detajuara në këtë mënyrë, kostoja e paguar vetëm në interes mbi bazën e investimit, arrin vlerën e rreth 270 milion euro për tre vite dhe 550 milion euro për mundësinë e amortizimit prej 5 vite.

Shuma e investuar nga Contour Global	Norma e interesit	Koha e amortizimit total të kredisë (# vite)	Shuma e kthyer (bazë + interes)	Shuma e paguar në interes
390,000,000	18.5%	3	663,121,762.42	273,121,762.42
		5	944,667,693.91	554,667,693.91

Tabela 2. Analiza e amortizimit total të investimit kapital nga Contour Global në ndërtimin e TC “Kosova e Re” (vlerat në euro)

Tabela më poshtë përfshinë koston e ndërtimit duke kalkuluar edhe shpenzimet nga norma e kthimit në kredi si dhe nga investitori privat. Kalkulimet përfshijnë edhe koston e subvencionit e cila pritet të mbulohet në rast se marrëveshja kushtëzohet të arrihet vetëm me interes shumë të favorshëm për kredihënësin. Kjo nënkupton se në rast se kredia e siguruar kalkulohet me një interes prej 18 përqind, shuma e paguar në interes për periudhën 20 vjeçare do të jetë 3.2 miliardë euro krahasuar me 1.3 miliardë euro nëse norma e interesit mirret të jetë 7.5 përqind. Diferenca e cila duhet të subvencionohet arrin vlerën e 1.9 miliardë euro.

Totali i kredisë dhe normës së kthimit	2,275,000,000
Totali i investimit privat dhe normës së kthimit	663,121,762.42
Kostoja e subvencionit	1,911,000,000
Kostoja totale e ndërtimit të TC “Kosova e Re”	4,849,121,762

Tabela 3. Analiza e kostonë së përgjithshme të ndërtimit të TC “Kosova e Re” (vlerat në euro)

Nga këto kalkulime kostoja e ndërtimit të termocentralit të ri arrin vlerën e rreth 4.8 miliardë euro, tre herë më e lartë sesa parashikimet e kostonë deri më tani me vlerë prej 1.3 miliardë euro. Duhet të mirret parasysh se Tabela më lartë merr parasysh kostonë e amortizimit të investimit të Contour Gobal për një periudhë prej 3 viteve. Në rast se amortizimi i investimit bëhet prej një periudhe prej 5 viteve, kostoja totale e ndërtimit mund të kap edhe vlerën e mbi 5 miliardë euro.


Ndikimi i ndërtimit të TC “Kosova e Re” në emimet e energjisë elektrike

Aktualisht, kostoja e operimit të Kosova A dhe Kosova B, që nënkupton ëmimin e energjisë elektrike është në nivelin e 28.93 EUR/MWh. Në rast se nuk ndërtohet termocentrali i ri dhe kapaciteti prodhues mbetet ky që është tani, por me përlllogaritje të normës së inflacionit prej 3 përqind, ëmimi i energjisë elektrike deri në vitin 2021 do të arrijë deri në 33.53 EUR/MWh. Marrëveshja aktuale për TC “Kosova e Re” parasheh ëmimin prej 80 EUR/MWh të energjisë elektrike. Për më shumë, në marrëveshje është e inkorporuar edhe kostoja e obligueshme e pagesës në rast të prodhimit të energjisë mbi sasinë e paraparë⁹. Ky obligim kërkon pagesë shtesë prej 20 përqind mbi ëmimin e dakorduar për intervalin kohor të prodhimit të energjisë me sasi më të lartë sesa ajo e paraparë. Në rast të tillë, ëmimi i energjisë elektrike mund të arrijë vlerën e 96 EUR/MWh. Në marrëveshje është përcaktuar edhe masa që duhet të merret në rast se energjia e disponueshme për shfrytëzim është nën nivelin e sasisë së parapë. Në këtë rast ndëshkimi parashihet të përcaktohet në bazë të diferencës ndërmjet sasisë së gjeneruar dhe asaj të paraparë. Mirëpo, ndëshkimi nuk është fiksuar më ndonjë përqindje specifike shtesë sikur në rastin paraprak.¹⁰

Konsideruar dallimin në mes të ëmimit aktual të energjisë dhe atij të përcaktuar nga marrëveshja e termocentralit të ri, rritja në ëmim do të arrijë deri në 176.5 përqind. Në rastet kur aplikohet bonus prej 20 përqind, rritja në ëmim do të mbërrijë vlerën deri në 231.8 përqind. Normalisht që kjo rritje do të rrisë edhe pjesën e të hyrave të qytetarëve të dedikuara për shpenzimet e energjisë elektr


Ndikimi i TC “Kosova e Re” në tarifat e energjisë elektrike

(Analizat në vijim do të fokusohen në atë se si Qeveria e Kosovës do të duhet të mbuloj koston në diferencën e cmimit të energjisë)



⁹ Power Purchase Agreement, 2.3.1 Bonus for Availability Above the Expected Availability, faqe 171.

¹⁰ Power Purchase Agreement, 2.3.2 Penalty for Availability Below the Expected Availability, faqe 171.



Kosotoja të cilën Qeveria e Kosovës duhet ta mbuloj për Contour Global

Kompenzimet të cilat duhet të mbulohen nga Qeveria e Kosovës për Contour Global dhe janë të parapara me marrëveshje përfshijnë kompenzimet për energjinë elektrike, pagesat për disponueshmëri dhe pagesat e tjera në baza mujore (Article 16).¹¹ Sa i përket kompenzimit për energji elektrike, marrëveshja parasheh kalkulimin për orë të pagesave për energji, të cilat përfshijnë ëmimin e linjtit, ëmimin e ujit të përdorur për metër kub, shpenzimet për gurët gëlqeror dhe shpenzimet e amoniakut për orë si dhe kostot e tjera të ndryshueshme (Schedule 1, Article 4).¹² Pagesat për disponueshmëri përfshijnë pagesat periodike të kredisë si dhe kostoja e normës së interes, taksën e korporatave, koston fikse të operimit dhe menaxhimit dhe kostot e tjera të përfshira (Schedule 1, Article 3).¹³ Së fundmi, pagesat e tjera të cilat priten të rimbursohen për GenCo përfshijnë pagesat për menaxhimin e punës së rrjetit elektrik.¹⁴ Të gjitha këto kompenzime duhet të mirren parasysh në vlerësimin e fizibilitetit të projektit, i cili në shumë aspekte shihet si një marrëveshje shumë e shtrenjtë dhe rëndon dukshëm buxhetin e vendit.

Ndryshimet e mundshme në ëmimin e energjisë

Në analizat dhe kalkulimet e mësipërme për bazë është marrë ëmimi i energjisë rreth 80 EUR/MWh pas ndërtimit të termocentralit të ri. Arsyeja e citimit të një ëmimi të tillë është fakti se ky ëmim i planifikuar është parapara me marrëveshje si dhe është përcaktuar si ëmim


¹¹ Power Purchase Agreement, Article 16: Compensation due to GenCo, faqe 120.

¹² Power Purchase Agreement, Schedule 1, Article 4: The energy payment, faqe 183.

¹³ Power Purchase Agreement, Schedule 1, Article 3: Calculation of the Base Availability Credit Amount Used to Determine the Monthly Availability Payments in each ½ Year Period, faqe 172.

¹⁴ Power Purchase Agreement, Article 1: Definitions; Interpretation, faqe 9.

tavan në deklaratat nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik. Mirëpo, në marrëveshje mund të vërehen disa aspekte të cilat bëjnë të mendojmë se ky ëmim është vetëm një udhërrëfyes dhe nëse inkorporohen kostot e tjera ai mund të jetë shumë më i lartë. Së pari, ëmimi i cituar në marrëveshje specifikon 80 EUR/MWh si një ëmim të planifikuar (target), që bën të kuptojmë se për kompaninë GenCo kjo shifër nuk konsiderohet si ëmim tavan por vetëm si objektiv i ndryshueshëm.



Përndryshe, në dhjetë vitet e fundit, në Kosovë, çmimi mesatar i importit ka qenë vetëm 67 euro dhe në pesë vitet e fundit vetëm 56 euro. Pra, edhe çmimi i importit është dukshëm më konvencues sesa çmimi i energjisë së prodhuar në Termocentralin Kosova e Re.

Së dyti, në marrëveshje janë përfshirë detajet e kalkulimit të kostove të ndryshme të cilat mund të jenë të ndryshueshme dhe gjithsesi mund të reflektojnë në ngritjen e ëmimit të paraparë. Për më tepër, ndryshimet në koston operacionale si dhe kostoja nga norma e interesit për pjesën e financimit përmes kredisë janë ende të panjohura, mirëpo pasi që këto do të jenë shpenzime shtesë, lirshëm mund të pritet të ngrisin ëmimin e energjisë edhe më shumë. Kështu që edhe pse ëmimi i energjisë fillimisht pritet të jetë në nivelin e 80 EUR/MWh, mundësitë për të arritur ëmim më të lartë janë të mëdha. Kuptohet se rritja e ëmimit të energjisë bënë këtë projekt edhe më pak të arsyeshëm ekonomikisht.

Një marrëveshje anti-evropiane

Me miratimin e legjislacionit të ri në fushën e energjisë në vitin 2016 Kosova kishte transpozuar tërësisht pakon e tretë të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë. Kosova është palë nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, një mekanizëm për përafrimin e legjislacionit dhe zhvillimit të tregut rajonal të energjisë me atë evropian. Pra ky është një traktat obligues për Kosovën në fazën deri para anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Komuniteti i Energjisë është dizajnuar si një instrument për liberalizim të tregut dhe integrim rajonal por gjithashtu për të drejtuar vendet e Ballkanit Perëndimor drejtë një sektori të pastër e të qëndrueshëm të energjisë.¹⁵ Ideja e liberalizimit të tregut ka lindur nga rregullat e konkurrencës së lirë dhe garantimit të funksionimit të një tregu fer të energjisë duke ndaluar pozitën favorizuese apo dominuese të njërit operator ndaj tjetrit.

Gjithashtu, në Objektivin 2 të Strategjisë së Energjisë 2016 – 2025 është paraparë qartësisht objektivi i Kosovës për liberalizim të tregut:

*Krijimin e kushteve për treg të liberalizuar brenda një tregu rajonal të energjisë ku nuk lejohet diskriminimi i palëve pavarësisht vendit të licencimit të tyre brenda Komunitetit të Energjisë, mbi parimin e reciprocitetit;*¹⁶

Me këtë marrëveshje, një nga operatorët e gjenerimit në Kosovë, “Kosova e Re” do të ketë të garantuar shitjen e energjisë me ëmim të paracaktuar¹⁷ Nuk mund të ketë treg të lirë e të liberalizuar në qoftë se njërit nga operatorët shteti ia garanton qymyrin sipas kërkesës së vet operatorit, sasinë enorme të ujit, blerjen e pandërprerë të energjisë, ëmimin dhe në fund plasimin me përparësi në treg!

Në kushtet e tanishme të kontratës, asnjë operator, as gjeneruesit nga burimet e ripërtrishme nuk do të kenë përparësitë që ka Contour Global. Përderisa skema e tarifave nxitëse ofron kontrata për 10 përkatësisht 12 vite kohëzgjatje me një ëmim që synon vetëm t’i bëjë këto investime konkurruese me tekologjinë konvencionale, Contour Global do të përfitoj nga një kohëzgjatje dyfish më e gjatë me të gjitha kushtet paraprake të plotësuar.

Kontrata gjithashtu shkelë legjislacionin e brendshëm të konkurrencës dhe atë të Bashkimit Evropian. Theks të veçant duhet vënë këtu në legjislacionin në Direktivat e BE për tregun e brendshëm dhe në Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Ky ligj e definon pozitën dominuese në treg si:

*pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët.*¹⁸

Kosova e Re dhe kushtet e kësaj kontrate e vënë pikërisht operatorin privat në pozitë tërësisht të pavarur dhe të pa ndikuar nga tregu. Rrjedhimisht “Kosova e Re” do të jetë plotësisht në pozitë dominuese ndaj prodhuesve të tjerë të energjisë të cilëve nuk i janë siguruar asnjë nga garancat që Contour Global ka me këtë marrëveshje.


¹⁵ Energy Community, (2018), Knocking on the EU’s Door through the Energy Community: Integration of Western Balkans into the Pan-European Energy Market, faqe 1, Vienna.

¹⁶ Republika e Kosovës, (2018), Strategjia e Energjisë, Objektivin 2. Integrimi Në Tregun Rajonal Të Energjisë, faqe 33, Prishtinë: MZHE.

¹⁷ Edhe pse është përmendur që ëmimi prej 80 euro MW, një ëmim i tillë do të jetë edhe më i lartë për konsumatorët fundor.

¹⁸ Republika e Kosovës, (2010), Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Neni 3, Përkufizimet, faqe 2, Prishtinë: GZRKS.

Kontrata gjithashtu shkelë dispozitat evropiane për Ndhimën Shtetërore. Kompania e Re Kosovare për Blerjen e Energjisë do ta marrë gjithë energjinë që e prodhon Kosova e Re me një ëmim të caktuar. Përveë që kjo shkatërron idenë e tregut liberal sepse presupozon ëmim të rregulluar të energjisë, ajo rrezikon që një pjesë e madhe e energjisë të blehet direkt përmes subvencionimit nga buxheti i shtetit. Nëse kompania e re nuk arrinë ta shes energjinë që e blenë nga Kosova e Re, e njëjta ose do të shitet me ëmim shumë më të lirë ose do të humbet fare. Diferencën do ta paguaj direkt përmes buxhetit, ëka shkelë legjislacionin në fushën e ndihmës shtetërore, minon implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të rrugëtimit të Kosovës në BE.



Private
 Publike

Dhunë për mjedisin dhe shëndetin

Kontrata për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re nuk përmbushë standardet më të mira mjedisore. Termocentrali i bazuar me qymyr di Kemi pasur deklarime se do të ketë teknologjinë më të fundit në mbrojtje të mjedisit. Një pjesë e konsiderueshme e studimeve mjedisore përfshirë studimi i mirëfillt i ndikimit mjedisor dhe social do të publikohen tek pas nënshkrimit të kontratës.

Qeveria e Kosovës krahas premtimeve se projekti do t'u përmbahet "standardeve më të larta mjedisore" është shoqëruar me kërkesën e vazhdueshme për "sa më shumë furnizim".

Këto kërkesa do të sigurojnë që Termocentrali Kosova e Re përdor teknologjinë më të mirë të mundshme dhe të menaxhojë në mënyrën më të mirë të mundshme, krejt kjo me qëllim të rritjes së furnizimit me energji duke minimizuar rrezikun për mjedisin dhe për shëndetin e komunitetit përreth.¹⁹

Pra, prioritet mbetet prodhimi sa më i madh nga burimet e linjtit. Në të njëjtën kohë, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë që Contour Global ka nënshkruar me Qeverinë e Kosovës i referohet teknologjisë së reduktimit të SOX dhe NOX vetëm "nëse kërkohet".²⁰ Nuk i referohet limiteve specifike të EU-së sa i takon emisioneve por i referohet standardeve të aplikueshme nga 2016 nën IED²¹ (p.sh 150mg/m³ NOX), jo limitet e reja të dakorduara të fillojnë së zbatuari nga viti 2021 (up to 85mg/m³) e që përbëjnë dallim të madh. Sa i takon CO₂ do të jetë "carbon capture ready" që nënkupton se reduktimi do të jetë vetëm marginal për shkak të rritjes së eficiencës së prodhimit.

Përfundimisht, pjesa më e madhe e studimeve që do të kenë impakt të drejtpërdrejtë në mjedis nuk janë kryer ende dhe një evaluim i dëmeve mjedisore ende nuk është bërë. Termocentrali i ri me linjit do të harxhoj sasi të mëdha të ujit dhe çështja e kontaminimit të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nuk është trajtuar sa duhet. Kosova madje, ende nuk ka të rregulluar një bazë ligjore për trajtimin e mbetjeve industriale.

Të gjitha kostot e rehabilitimeve mjedisore do të kryhen nga Qeveria e Kosovës.²² Kjo edhe më tutje do të rrisë koston që ky projekt ka. Marrëveshja thotë që vetëm nëse kompania kosovare e sheh të nevojshme, dhe duke njohur barrën e pagesës qo do të ketë, mund të ndodhë rehabilitimi i mjedisit. Përfundimisht, aspektet mjedisore të projektit Kosova e Re nuk janë prioritetizuar dhe kompania private edhe në këtë rast, nuk është përkushtuar për mbrojtje mjedisore sipas standardeve më të fundit.

Një element tjetër i rëndësishëm i kontratave është çështja e pluhurit. Pluhuri do të transportohet duke përdorur teknologjinë e tanishme hidraulike të transportit e cila po shkakton

¹⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2017), Pavarësi Energjetike për Kosovën, Pyetjet më të Shpeshta, faqe 21, MZHE.

²⁰ Kosovo Government and Contour Global, (2017), Power Purchase Agreement, Article 15, Environmental Remediation, page 115.

²¹ European Industrial Emissions Directive.

²² Ibid.

ndotje të mëdha të ujit (ujë të kaltër) me përqëndrim pH13 dhe kemikate shumë të dëmshme. Zgjidhja për këtë problem nuk është dhënë dhe as kostoja nuk është përlogaritur. Gjithashtu, koston e plotë të dekomisionimit do ta paguajnë qytetarët e Kosovës 100%.

Përfundime

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet menjëherë të njoftojë tërheqjen nga marrëveshja për ndërtimin e termocentralit me linjit Kosova e Re. Megjithë implikimet financiare që mund të ketë tërheqja nga nënshkrimi kontrata për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, si e tillë, është e dëmshme si në aspektin ekonomik, mjedisor, dhe të integritimit evropian. Në të tri këto rrafshje, do t'i sjellë Kosovës çmim shumë të lartë për një investim të së kaluarës, nuk do të sigurojë mbrojtje të mjedisit dhe do ta shkatërrojë të ardhmen evropiane të Kosovës. Ndalja dhe anulimi i kësaj kontrate janë të domosdoshme për t'i hapur rrugë dialogut të vërtetë shoqëror mbi të ardhmen e sistemit energjetik të Republikës së Kosovës.

Kontratat e ofruara e sjellin Kosovën në prag të kolapsimit ekonomik. Investitorit do t'i garantohen të gjitha kushtet dhe benefitet për të operuar në një treg që do të duhej të ishte konkurrent dhe liberal. Kështu, Contour Global, me investimin e tij ka siguruar një normë shumë të lartë të kthimit me praktikisht zero risk. Rrjedhimisht, qytetarët do të paguajnë çmim dukshëm më të lartë të energjisë elektrike për të mbuluar investimin, fitimin e Contour Globalit, dhe normën e kredisë e cila është ende e paparashikueshme.

Kontratat e nënshkruara nga Qeveria e Kosovës dëmtojnë seriozisht akterët e tjerë në tregun e energjisë në Kosovë. Pozita dominuese e Contour Globalit në tregun e energjisë do të konkretizohet duke ia garantuar shitjen e plotë të të gjithë energjisë që e prodhon për njëzet e katër orë. Kjo bie ndesh me legjislacionin vendor në fushën e mbrojtjes së konkurrencës në treg dhe shkatërron idenë e liberalizimit të tregut.

Legjislacioni evropian në fushën e energjisë, i adoptuar për Kosovën përmes Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është i qartë në objektivën për të realizuar një treg të përbashkët rajonal të energjisë elektrike dhe për të liberalizuar tregun. Kjo mund të realizohet vetëm me diversitet të furnizuesve të energjisë dhe me prodhues të saj që garojnë në një treg fer të përbashkët. Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re dhe kontrata aktuale e nënshkruar dëmton rëndë të ardhmen evropiane të Kosovës dhe e vë atë në pozitë tejet të vështirë në relalizimin e aquis në pjesën e tregut të përbashkët energjetik, të mbrojtjes së konsumatorit, të liberalizimit të tregut, konkurrencës në treg dhe parandalimin e ndihmë shtetërore.

Kostoja e ndërtimit të termocentralit të ri nuk kufizohet vetëm në çmimin së paku të dyfishuar të energjisë të cilin do ta paguajmë. Qeveria e Kosovës është zotuar që të paguaj edhe një sërë kostosh shtesë që ndërlidhen me investime në miniera, në flotacion të qymyrit dhe në studime të shumta që do ta shoqërojnë realizimin e projektit. Të gjitha këto kosto rrisin në mënyrë eksponenciale koston përfundimtare të cilën do ta ketë projekti. Përveç kësaj, të gjitha kostot shtesë që do të dalin nga procesi i integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (kryesisht

taksa në karbon që do t'i imponohet Kosovës), do të paguhet nga Qeveria e Kosovës dhe jo nga Contour Global.

Projekti për ndërtimin e termocentralit dhe kontrata e nënshkruar garantojnë sigurinë e furnizimit vetëm në modelin aktual të izoluar të sistemit tonë energjetik. Në një treg të liberalizuar dhe të integruar të energjisë, blerja e pandalshme e të gjithë kapacitetit të prodhuar nga kompania kosovare vetëm sa do të rrisë barrën buxhetore dhe kjo energji do të jetë shumë e shtrenjtë në një treg konkurrent rajonal.

Çmimi i proklamuar si “çmimi tavan” prej 80 eurosh për megavat është vetëm çmimi startues për kompaninë. Ky çmim është për 42% më i lartë sesa çmimi mesatar i importit në pesë vitet e fundit në bazë të raporteve të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Në një kohë kur tendenca e çmimeve të energjisë është në rënje, Kosova ka garantuar një çmim për njëzet vitet e ardhshme që do të jetë shumë më i lartë sesa çdo kalkulim i kostos.

Përfundimisht, një pjesë e rëndësishme e standardeve mjedisore në kontratë janë vetëm opsionale dhe nuk kanë karakter obligativ. Shkarkimet industriale, dëmet në ujërat nëntokësore, deponitë e hirit dhe çështje të tjera tepër të rëndësishme kanë mbetur të kryhen me studime tek pasi të filloj projekti. Përfundimisht, një kontratë e tillë është marrëveshja më e dëmshme që Kosova ka nënshkruar që nga paslufta. Ajo do t'i sjellë Kosovës kosto shumë të lartë, do ta çrregulloj sistemin energjetik dhe do të pengojë liberalizimin dhe integrimin e tij si dhe do të dëmtoj mjedisin dhe të ardhmen evropiane të Kosovës.